

POLITIKAT NË FOKUS: ZBATIMI I

KONTRATAVE



Rreth publikimit 'Politikat në Fokus'

Në vitin 2016, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, ka filluar publikimin e dokumentit 'Politikat në Fokus' – i cili ka për synim të sjellë vëmendjen në politika të ndryshme ekonomike. Më tutje, ky dokument gjithashtu ka për qëllim të përmbledhë sfidat për zhvillimin e politikave të tilla në mënyrë që të hapet rruga drejt adresimit të tyre. Ky dokument do të publikohet në baza dymujore. Përderisa ky edicion i parë vë fokusin në Zbatimin e Kontratave në Kosovë, edicionet e ardhshme do të jenë mbi politika të tjera me interes për sektorin privat.

Fokusl në Zbatimin e Kontratave në Kosovë

Ky dokument paraqet një përmbledhje të sistemit gjyqësor në Kosovë, me fokus në zbatimin e kontratave, kualitetin e sistemit gjyqësor, dhe kohën dhe koston e lidhur me zgjedhjen e kontesteve. Zhvillimi ekonomik dhe rritja e qëndrueshme janë të lidhura ngushtë me efikasitetin e zbatimit të kontratave Sundimi i ligjit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut kërkojnë një gjyqësor funksional, të parashikueshëm dhe të qasshëm, përmes të cilit gjykatat mund të zbatojnë obligimet kontraktuale në mënyrë efektive.

Një gjyqësor i fuqishëm dhe efektiv është lidhur ngushtë me tregjet e zhvilluara të

kredive, rritjen më të shpejtë të bizneseve të vogla dhe nivel më të lartë të zhvillimit të përgjithshëm.

Poashtu, zbatimi i kontratave është një ndër treguesit kryesor të cilin investitorët e huaj e kanë parasysh para se të marrin vendime për investimet e tyre.

Rritja e efektivitetit të zgjedhjes së kontesteve komerciale ka shumë përparësi:

- i. përmirëson ambientin e të bërit biznes, nxit inovacionin dhe rrit investimet e huaja direkte;
- ii. mundëson zbatime më të besueshme dhe efikase të kontratave;
- iii. nxit institucionet financiare të ofrojnë norma më të ulëta të interesit; dhe zvogëlon numrin e lëndëve të pazgjijdhura dhe parandalon krijimin e tyre në të ardhmen.

Pasqyrë e Zbatimit të Kontratave

Në përpjekje për të rritur efikasitetin e zbatimit të kontratave, duke bërë kështu procedurat për zbatimin e kontratave më të shpejta dhe më të lehta, shtetet kanë tendencë të prezantojnë reforma, siç është rasti i teknologjisë së re në ekonomitë me të ardhura më të larta dhe rasti i rishikimeve periodike për të fshirë lëndët joaktive në ekonomitë me të ardhura më të ulëta.

Në kuadër të të qenit indikator kyç për rritje dhe qëndrueshmëri ekonomike dhe promovim të efikasitetit në sistemet komerciale gjyqësore, praktikat e mira gjyqësore janë thelbësore sidomos për bizneset e vogla, duke pasur parasysh që gjykatat interpretojnë rregullat e tregut dhe mbrojnë të drejtat ekonomike.

Poashtu, gjykatat e përgjegjëse dhe transparente inkurajojnë marrëveshje dhe raporte të reja ndërmjet bizneseve, sepse bizneset mund të mbështeten në gjykaqa nëse përballen me klientë apo partner biznesi të cilët nuk i kryejnë obligimet ndaj tyre.

Gjykimet e shpejta, në kuptim të procedurave, kohës dhe kostos për zgjidhjen e një kontesti komercial, janë thelbësore për bizneset e vogla në këtë aspekt. Bizneset do të mund të qëndronin në treg edhe nëse do t'u mungonin burimet e nevojshme, në vend të pritjes së rezultatit të një kontesti të zgjatur gjyqësor.


Zbatimi i Kontratave- Kosovë

Ku qëndron ekonomia e Kosovës sot?

Zbatimi i kontratave dhe sundimi i ligjit përmenden shpesh si dy problemet kryesore me të cilat ballafaqohet Kosova sot. Mungesa e efikasitetit të gjykatave, perceptimi i korrupsionit në sektor dhe elemente të tjera negative kanë dëmtuar imazhin e sektorit gjyqësor. Kjo si pasojë ka efekt të dëmshëm në ambientin e të bërit biznes, përmes të cilit investitorët ballafaqohen me pasiguri dhe rreziqe të larta.

Si bizneset ashtu edhe ekspertët ankohen për kapacitetet dhe ekspertizën profesionale të gjyqtarëve për të marrë vendime, posaçërisht në lëndët komerciale, të cilat shpesh krijojnë marrëveshje komplekse ndërmjet palëve. Ka poashtu një numër të madh të ankesave sa i përket efikasitetit dhe kapacitetit profesional të gjykatave për të trajtuar çështje të natyrës fiskale.

How Kosovo and comparator economies rank on the ease of enforcing contracts



Duke u bazuar në situatën e përshkruar më lartë, duhet theksuar se sektori në përgjithësi ka qenë në fokus të shumë organizatave donatore ndërkombëtare, të cilat kanë siguruar ndihmë teknike dhe financiare në gjyqësor. Vitet e fundit kanë shënuar rritje në numrin e reformave dhe prezantimin e mekanizmave të rinj, të cilët kanë përmirësuar situatën e zbatimit të kontratave deri në një masë, detajet mbi të cilën janë të paraqitura në paragrafët në vijim.

Sipas të dhënave të "Të Bërit Biznes", të mbledhura dhe të siguruar nga Raporti Vjetor i të Bërit Biznes në 2016, zbatimi i kontratave në Kosovë merr 330 ditë dhe kushton 34.4% e vlerës së kërkesës. Renditja e paraqitur në grafikun e mëposhtëm për ekonominë krahasuese dhe mesataren e renditjes rajonale, të dyja paraqesin standarde të dobishme për të krahasuar efikasitetin e zbatueshmërisë së kontratave në Kosovë. Kosova prezantoi një sistem përmbarrimor privat në një përpjekje për të bërë më të lehtë zbatimin e kontratave (p.78). Kosova qëndron në renditjen e 48 në raport me 189 ekonomi mbarë botës, sipas lehtësisë së zbatimit të kontratave.

Koha dhe kostoja e zbatimit të kontratave në Kosovë

Të dhënat e mbledhura sipas kohës dhe kostonë së zbatimit të kontratave në Kosovë raportohen në bazë të një vlerësimi "hap-pas-hapi" të kontesteve të shitjeve komerciale. Koha nënkupton ditët që nevojiten për të zbatuar një kontratë përmes gjykatave, ndërsa kostoja nënkupton përqindjen e vlerës së kërkesës, në të cilën janë të përfshira tarifat e noterit, gjykatës dhe zbatimit të kontratës. Siç është paraqitur në tabelën e mëposhtme, koha mesatare e nevojshme për të zbatuar një kontratë në Kosovë është 330 ditë, në krahasim me mesataren e Evropës dhe Azisë Qendrore, e

cila është 481 ditë. Sidoqoftë, kostoja e zbatimit të një kontrate përmes gjykatave në Kosovë është më e lartë se në Evropë dhe Azinë Qendrore.


Indikatori	Kosova	Mesatarja e Evropës dhe Azisë Qendrore
Koha (ditë)	330	481
Plotësimi i dokumenteve dhe shërbime të ngjashme	60	
Procedura gjyqësore dhe vendimi	180	
Zbatimi i vendimit	90	
Kostoja (% e rastit)	34.4	26.2
Tarifat e avokatit	25.2	
Tarifat gjyqësore	7.8	
Tarifat e zbatimit të vendimeve	1.4	

Indeksi mbi cilësinë e proceseve gjyqësore

Indeksi mbi cilësinë e proceseve gjyqësore është matës i cili tregon nëse një ekonomi ka miratuar praktikën e nevojshme në sistemin e saj gjyqësor në katër fusha:

- i. Strukturën dhe procedurat e gjykatave;
- ii. Menaxhimin e lëndëve;
- iii. Menaxhimin e gjykatave; dhe
- iv. Zgjidhja alternative e kontesteve.

Indeksi i cilësisë së proceseve gjyqësore në Kosovë dhe ekonomitë krahasuese



Indeksi mbi cilësinë e proceseve gjyqësore nënkupton shumën e pikëve në komponentët e lartpërmendura dhe indeksi shkon nga 0-18, ku vlerat më të larta nënkuptojnë procese gjyqësore më efikase.


Grafiku i mëposhtëm tregon se cilat nga këto praktika, të testuara në bazë të indeksit mbi cilësinë e proceseve gjyqësore dhe i zhvilluar në bazë të praktikave të mira të njohura ndërkombëtarisht që sigurojnë efikasitet gjyqësor, janë të pranishme në Kosovë.

Përdorimi i kontratave në Kosovë

Në bazë të një hulumtimi të USAID, 81.72% nga 900 biznese përdorin kontratat me shkrim për transaksionet e tyre afariste. Përdorimi i kontratave për transaksione afariste është rritur pozitivisht prej vitit 2011 në 2014. Megjithatë, binzeset në Kosovë ende ballafaqohen me sfida dhe paqartësi, si pasojë e njohurive të kufizuara rreth sistemit gjyqësor në Kosovë, burimeve dhe kapaciteteve të kufizuara, dhe besimi i ulët apo inekzistent në sundimin e ligjit, të cilat kanë penguar funksionimin dhe rritjen e

qëndrueshme të bizneseve (USAID p.14, 2015).

Raporti i të bërit Biznes



Efikasiteti i zbatimit të kontratave, i vlerësuar nga raporti i Bankës Botërore "Raporti Vjetor i të Bërit Biznes" ka pësuar rënie në 2016, në krahasim me pozicionin e saj në 2015, nga 46 në 48, respektivisht.


Përmbaruesit privat

Duke pasur parasysh reformat ligjore, të cilave sistemi gjyqësor iu nënshtua në vitin 2013, vonesat në zgjidhjen e lëndëve, mungesa e llogaridhënies dhe transparencës, perceptimi i lartë i korrupsionit dhe sfidat në vendimet për zbatim janë çështje kyçe të ngritura nga sektori privat (V. P.13).

Të dhënat tregojnë se zgjidhja e kontesteve është rritur në vitin 2015, duke treguar kështu një sistem gjyqësor më efikas në këtë aspekt. Megjithatë, pavarësisht numrit në rritje të lëndëve të zgjidhura, numri i lëndëve në pritje është rritur për 31%. Një mospërputhje e fillë reflekton mungesën e stafit ligjor mbështetës, të cilët konsiderohen shumë të rëndësishëm dhe të nevojshëm gjatë ballafaqimit më rritjen e kërkesës për lëndë brenda departamentit komercial.

Zbatimi i kontratave matë cilësinë dhe efikasitetin e zgjidhjes së kontesteve komerciale dhe si i tillë, është një ndër elementet më të rëndësishme veçanërisht për investitorët e huaj, gjatë kohës kur u duhet të zgjedhin një destinacion për të investuar.

Në këtë aspekt, “sistemi i zbatimit privat ka ndihmuar vazhdimisht në zgjidhjen e vendimeve dhe rritjen e vetëdijes së debitorëve në kryerjen e obligimeve të tyre. Një shembull shumë i thjeshtë do të ishte norma ndjeshëm e lartë e mbledhjes së borxheve ndaj ofruesve të shërbimeve publike, si energjia elektrike ose grumbullimi i mbeturinave, ku debitorët paguajnë borxhet vazhdimisht, në mënyrë vullnetare.” Analogji e njëjtë mund të bëhet edhe për kryerjen e obligimeve të biznesit falë prezencës së një mekanizmi më efikas për zbatim, i cili nxit kryerjen e obligimeve në mënyrë vullnetare” (V. P.15).



Mekanizmat për zgjedhjen alternative të kontesteve

Arbitrazhi dhe ndërmjetësimi janë dy mekanizma për zgjidhjen alternative të kontesteve, të cilat përdoren në kontestet komerciale mbarë botës.

Arbitrazhi

Si një alternativë procedurave tradicionale gjyqësore, arbitrazhi karakterizohet me procedura më të shpejta, konfidencialitet më të lartë, dhe ofron një mundësi që kontestet e natyrës komerciale të zgjidhen nga ekspertë të çështjes. Si i tillë, arbitrazhi është në përgjithësi një proces më pak kundërshtues, që nxit palët të mbajnë marrëdhënie të shëndetshme afariste. Arbitrazhi siguron një alternativë më pak të kushtueshme duke pasur parasysh rritjen e efikasitetit për zgjidhjen e kontesteve e që rezulton në uljen e kostos së noterizimit dhe procedurave tjera.

Ndërsa historia e arbitrazhit daton që nga shekujt 15 dhe 16, atëherë kur janë themeluar rregullat e para, arbitrazhi zyrtarisht ka filluar të përdoret në Evropë në shekullin 20 (CLE Training Manual on Arbitration). Ky mekanizëm për zgjidhjen alternative të kontesteve është zhvilluar gjerësisht në Republikën Jugosllave në fillim të vitit 1970 me institucione të specializuara të arbitrazhit, vendimet e të cilave përdoren ende si precedentë ligjor në rastet tjera.

Në kohën e pasluftës në Kosovë, ligji i parë është miratuar në vitin 2007 dhe i njëjti ka hyrë në fuqi në vitin 2008. Ky ligj është i natyrës komerciale dhe vlen vetëm për zgjidhjen e kontesteve të natyrës së tillë.

Klauzola model e Arbitrazhit

“Çdo mosmarrëveshje, mospajtim, ose pretendim që del nga apo në lidhje me këtë kontratë, duke përfshirë shkeljen, ndërprerjen ose jo-vlefshmërinë e kontratës, do të zgjidhet me arbitrazh në kuadër të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Kosovës.

Pas krijimit të kornizës ligjore, me ndihmën e donatorëve ndërkombëtarë, kryesisht me programet e USAID (siç janë SEAD, CLE, etj.) Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) dhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë kanë themeluar qendrat e tyre të veçanta për zgjedhjen alternative të kontesteve, të quajtura "Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit" dhe "Qendra e Arbitrazhit e Odës Amerikane (e njohur më parë si "Qendra për Zgjedhjen Alternative të Kontesteve").

Gjatë viteve, të dy institucionet kanë punuar vazhdimisht në rritjen e kapaciteteve të tyre duke krijuar një listë profesionale të abitrave, duke përmirësuar kapacitetet eksistuese dhe duke miratuar rregulloret e brendshme përkatëse.

Tani, Qendra e Arbitrazhit pranë Odës Amerikane numëron 40 arbitra, nga të cilët një pjesë e madhe janë avokatë ndërkombëtarë me përvojë të madhe në fusha të ndryshme. Për më shumë, kjo Qendër ka punuar në vazhdimësi me komunitetin e biznesit për të ngritur vetëdijen mbi përfitimet e përdorimit të arbitrazhit dhe për të këshilluar bizneset që të përfshijnë klauzolat e arbitrazhit në kontratat e tyre. Përderisa proceset e arbitrazhit mund të kryhen edhe pa ekzistimin e një klauzole të arbitrazhit, me kusht ë palët pajtohen pas kontestit që atë ta zgjedhin përmes këtij mekanizmi, prezenca e një klauzole të tillë është e preferueshme në mënyrë që të evitohet hezitimi i ndonjërës palë që të nënshkruajnë një marrëveshje pas lindjes së kontestit.

Arbitrazhi në Kontratat e Prokurimit Publik

The Public Procurement Regulatory Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) ka përfshirë klauzolat e arbitrazhit në format standarde të dosjeve

tenderuese, megjithatë një klauzolë e tillë perceptohet në raste të ndryshme si klauzolë patologjike, për shkak të faktit se KRPP nuk i lejon palët që të heqin referencën në procedurat gjyqësore. Rrjedhimisht, pothuajse të gjitha autoritetet kontraktuese refuzojnë të lejojnë kompanitë që të zgjedhin arbitrazhin në kontratat e tyre të prokurimit publik. Mes iniciativave të marra nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë vitin e kaluar për promovimin e mekanizmave alternativë për zgjedhjen e kontesteve është edhe propozimi që Ligji i Prokurimit Publik të parasheh që përpos procedurave tradicionale gjyqësore, të lejohet specifikisht edhe përfshirja e klauzolave të arbitrazhit në kontrata të prokurimit. Një hap i tillë do t'i qartësonte palëve se kanë të drejtën të zgjedhin arbitrazhin si alternativë e gjyqësorit, dhe si e tillë do të ndihmonte në reduktimin e kohës të nevojshme për të zgjidhur konteste të mundshme dhe do të zvogëlonte barrën e gjyqësorit.

Një hap i tillë nuk është mbështetur nga Kuvendi i Kosovës dhe rrjedhimisht nuk është përfshirë në Ligjin e Prokurimit Publik.

Ndërmjetësimi

Ndërmjetësimi është mekanizëm në të cilin një person neutral i ndihmon palët që të arrijnë marrëveshje mbi një kontest. Për dallim nga arbitrazhi, ndërmjetësimi nuk rezulton në vendim final të detyrueshëm, por bazohet në vullnetin e palëve që të arrijnë në një zgjidhje

Klauzola model e Ndërmjetësimit

"Çdo mosmarrëveshje, mospajtim, ose pretendim që del nga apo në lidhje me këtë kontratë, duke përfshirë shkeljen, ndërprerjen ose jo-vlefshmërinë e kontratës, palët pajtohen që fillimisht të provojnë ta zgjidhin përmes ndërmjetësimit në kuadër të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë në pajtim me rregullat e Ndërmjetësimit të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Nëse nuk arrihet marrëveshje brenda 30 ditëve, apo ndërmjetësimi dështon më herët, palët do ta zgjidhin rastin përmes arbitrazhit pranë Odës Ekonomike Amerikane në pajtim me rregullat e Arbitrazhit në fuqi.

të pajtueshme.

Ligji Nr. 03/L-057 mbi Ndërmjetësimin përbën bazën kryesore ligjore për funksionimin e ndërmjetësimi si mekanizëm alternativ për zgjidhje të kontesteve në Kosovë.

Në përgjithësi, ndërmjetësimi raportohet si i suksesshëm, dhe bizneset kanë treguar tendencë më të madhe të përdorimit të ndërmjetësimi krahasuar me arbitrazh. Një nga arsyt kryesore është edhe kostoja e ndërmjetësimi, që është shumë më e ulët se e arbitrazhit. Ministria e Drejtësisë ka raportuar për një numër në rritje të rasteve të ndërmjetësimi të urdhëruar nga gjykatat. Numri i rasteve të ndërmjetësimi në Qendrën e Arbitrazhit të Odës Amerikane gjithashtu më i lartë se i rasteve të arbitrazhit. Për më shumë, sipas Anketës Kombëtare mbi Përdorimin e Kontratave 2015, përderisa 58% e respondentëve ende preferojnë gjykatat, 12% dhe 3.7% kanë cituar ndërmjetësimin, respektivisht arbitrazhin, si metodën e preferuar për zgjedhjen e kontesteve. Raporte të ngjashme të vitit 2014, kanë rezultuar se 22% e respondentëve preferojnë ndërmjetësimin, përderisa arbitrazhi nuk është listuar fare. Gjykatat edhe atë vit kanë zënë vendin e parë me 47%.

Hapat e mëtutjeshëm

Mekanizma të fuqishëm dhe efektivë për zbatimin e kontratave janë të rëndësishë jetike për zhvillimin e sektorit privat në Kosovë. Indikatorët për zbatimin apo ekzekutimin e kontratave shpesh janë pikë reference për investitorë për të përllogaritur riskun dhe pasigurinë për të investuar në një vend. Duke pasur këtë në konsideratë, është shumë e rëndësishme për institucionet e Kosovës që të vazhdojnë reformat në sektorin gjyqësor në konsultim të afërt me të gjitha palët e interesit. Në mënyrë që të përmirësohen mekanizmat për zbatimin e kontratave dhe të përmirësohet pozita e Kosovës krahasuar me shtetet tjera të rajonit, deri tani palë të

ndryshme kanë dhënë rekomandime të ndryshme se si të vazhdohet tutje. Nga perspektiva e sektorit privat, nevoja për të rritur kapacitetet e gjyqësorit, veçanërisht në departamentin komercial, është evidente, qoftë në aspekt të numrit të gjyqtarëve, apo në aspekt të emërimit të bashkëpunëtorëve profesional që do të ndihmojnë gjyqtarët në raste.

Duke pasur parasysh këtë, mundësia e themelimit të një dhome të posaçme për trajtimin e kontesteve biznesore gjithashtu është ngritur nga komuniteti i biznesit. Një hap i tillë do të ishte i mirëseardhur vetëm nëse do të rezultonte që rastet të trajtohen me efikasitet më të lartë nga gjyqtarë kompetentë me ekspertizë komerciale.

Në përfundim, përmirësimet e shënuara në këtë dokument sa i përket zbatimit të kontratave janë inkurajuese, pasi që progresi i bërë është reflektuar edhe në indikatorët e të bërit biznes. Sidoqoftë, hapat e mëtutjeshëm mbeten sfidues. Promovimi i arbitrazhit dhe ndërmjetësimi, rritja e kapaciteteve të sektorit gjyqësor dhe paraqitja e mekanizmave profesionalë të cilët trajtojnë konteste afariste janë të domosdoshme nëse shteti ka për qëllim të inkurajojë investimet e huaja dhe zhvillimin ekonomik.

Referencat

Input për Raportin e Progresit: Ballafsqimi me Presionin Konkurrues, Funksionimi i Ekonomisë së Lirë të Tregut, Sundimi i Ligjit, dhe Prokurimi Publik. *Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. Gusht 2016.*

Raporti i të Bërit Biznes 2016. *Banka Botërore. 2016.*

Anketa Kombëtare mbi Përdorimin e Kontratave të Shkruara. *Programi i USAID për Legjislacion Komercial. 2016.*